



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.225, Datë 22.10.2019

PËR

**KOMANDIMIN E ZNJ. {...} SI PEDAGOGE E BRENDSHME
NË DEPARTAMENTIN E FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË
MAGJISTRATURËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 54 pika 6 e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 113, datë 09.07.2019 “Për shpalljen e rihapjes së procedurës për komandim të një gjyqtari në pozicionin pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Afati i komandimit fillon më datë 15 nëntor 2019.
3. Afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cënim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
4. Urdhërohet përjashtimi i menjëhershëm i gjyqtares znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR